9	Aksione te thesari te riblera							0
II	Pozicioni me 31 dhjetor 2012	267,745,000	0	0	1,662,351	-26,606,312	0	242,801,039

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-15

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Nord Konstruksion shpk, në vijim e quajtur "Shoqëria", është themeluar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës nr.35321 date 28.03.2006 . Ne momentin e themelimit ortakë të kapitalit prej 100 mijë lekësh ishte Zoti Ilir Tafilica dhe znj. Kristina Gjini Ajo është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Në fund të vitit 2012 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 267,745,000 lekë dhe është ndare në 100 pjesë me vlerën nominale prej 2,677,450 leke secila.

Objekti i saj kryesor është industria e ndertimit.

Në datën e këtyre PF struktura e zoterimit të kapitalit paraqitet si vijon:

Administratori ligjor i shoqërisë është z. ILIR TAFILICA

Adresa e Shoqërisë është : Rr. Don Bosko, Tiranë

Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degen e Tatimpaguesve të Medhenj me NIPT K619210180

Më 31 Dhjetor 2012 shoqëria ka 11 punonjës (31 Dhjetor 2011, 10 punonjës)

2. Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabel

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike dhe paraqiten në monedhën vendase Lekë. Kontabiliteti i shoqërisë mbahet me programin Financa 5 .

Politikat kontabël për shifrat e vitit 2012 janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe paraqiten në shënimin vijues...

3. Politikat kontabel kryesore

Një përmbledhje e pjesës më të madhe të politikave kontabel mbi bazën e të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur sa më poshtë:

3.1 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë MM në dore dhe ato të mbajtura në banka. Ato vlerësohen me vlerën e tyre të kembimit në fund të periudhës raportuese

3.2. Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientat dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogaritë e Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientat e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientat ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësive për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa. Shoqëria vlerëson cdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet nëshpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çrregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtat parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

Një aktiv financiar sipas përkufizimit të SKK 3 "Instrumentat financiare: Shënime shpjeguese dhe Paraqitja" çrregjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Shoqëria parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

3.3 Monedha e paraqitjes dhe Transaksionet në monedhë të huaj

(a) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

(b) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet,

regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “të tjera të ardhura (shpenzime) financiare”.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2012 janë:

Data / Monedha	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
Euro	139.59	138.93
USD	105.85	107.54

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 “Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe prfitimet në lidhje me to, dhe kur kosotja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e cmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të vogël midis koston (dhe vlerës neto të realizueshme). Kostoja matet me metodën e koston mesatare të ponderuar

Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.

3.5 Aktivët e Afatgjatë Materiale (AAM)

(i) Njohja dhe vlerësimi

AAM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka) Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. Aam paraqiten në bilanc me vlerën neto nga amortizimi

(ii) Amortizimi

Amortizimi i ndërtesave llogaritet dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metoden lineare. Ndërsa për të gjithë zërat e tjerë amortizimi llogaritet dhe njihet me metoden e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit janë të paraqitura si më poshtë:

NORD KONSTRUKSION SH.P.K.
SHËNIMET SHPJEGUESE

	<i>Norma Amortizimit %</i>	<i>Metoda Llogaritjes</i>
Ndërtesa	5%	Metoda lineare
Makineri e pajisje	20	Me Vleften e mbetur
Mjete Transporti	20	Me Vleften e mbetur
Mobilje Orendi	20	Me Vleften e mbetur
Pajisje Informatike	25	Me Vleften e mbetur

3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara. Në shpenzimet e parapaguara shoqëria ka përfshirë edhe pagesat që ka bërë për marrjen e lejeve të ndërtimit për objektet që janë në ndërtim e sipër dhe projektet e ndërtimit të tyre.

3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtëra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtëra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe te detyrime të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurieve shoqërore dhe shëndetsore janë paraqitur me shumen e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtëra njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë.

Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël. Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar. çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shoqëria nuk ka gjendje hua afatgjata në fund të periudhës raportuese.

3.8 Provizionet

Provizioni njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të bëhet një vlerësim relativisht i sakte i shumës së detyrimit.

3.9 Tatimi aktual mbi fitimin

Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimi e shtyrë. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohjura sipas përcaktimit të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat". Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

3.10 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve (punimeve) njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo. Shoqëria ka njohur të ardhura nga shitja vlerën pa TVSH të situacioneve të raportuara cdo muaj

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëhere kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato. Shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të klasifikuara sipas funksionit

4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkën e shoqërisë.

Konvertimi i gjendjes në valutë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2012 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në valutë të huaj janë sistemuar në rezultat.

4.1 Mjetet Monetare në bankë

Gjendja e llogarive bankare në fund të periudhës 2012 paraqitet si vijon:

Mjete monetare në banke	Viti 2012 Në lekë	Viti 2011 Në lekë
Banka Alfa (lek & Euro)	30,773.82	
Banka Kombetare Tregetare (Lek & Euro)	5,409,213.42	
Raiffeisen Bank (Lek & Euro)	2,997,312.62	
Instesa San Paolo Bank	63,587.36	

NORD KONSTRUKSION SH.P.K.
SHËNIMET SHPJEGUESE

Banka Societe Generale	2,633,118.38	
Totali	11,134,005.6	10,466,352

4.2 Mjetet monetare në arkë

Mjete monetare në arkë	Viti 2012 Në lekë	Viti 2011 Në lekë
Arka në lekë	6,276,181	127,413
Totali	6,276,181	127,413

Në pasqyrën e fluksve monetare efekti i kurseve të këmbimit në fund të vitit i likuiditeteve gjendje është paraqitur bashkë me efektin e konvertimit të gjendjeve të të drejtave dhe furnitorëve në monedha të huaja.

Në ndërtimin e PF të vitit 2012 nuk ka ndryshim në politikat kontabël të njohjes, vlerësimit dhe të konvertimit të veprimeve dhe gjendjeve të likuiditeteve në monedha të huaja.

5. Aktive të tjera afatshkurtra financiare

5.1 Kërkesa ndaj klientëve

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientave gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2012, që është vlera e situacioneve progresive të akumuluar deri në këtë datë. Shoqëria në lidhje me kërkesat e arkëtueshme ka zbatuar të njëjtat politika kontabël si dhe në vitin e kaluar. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientave sipas objekteve jepet në tabelën vijuese:

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	Viti 2012 Në lekë	Viti 2011 Në lekë
Klientë	395,712,593	465,771,249
Debitorë të tjerë (Kërkesa të arkëtueshme të tjera)	1,891,078	
Tatim mbi Fitimin	1,202,144	2,144
Tvsh	235,334	124,290
Parapagese Te Furnitoreve		1,206,306
Totali	399,041,149	465,897,683

5.2 Kërkesa të arkëtueshme të tjera

Në këtë zë paraqiten hua dhënë të tretëve me afat të shkurtër kthimi pa interes.

5.3 Kërkesa për tatimin mbi fitimin

Në këtë zë paraqitet shuma e mbipaguar nga shoqëria për tatimin mbi fitimin gjatë vitit 2012

5.4 Kërkesa për tatimin mbi vlerën e shtuar

Në këtë zë paraqitet diferenca pozitive midis tatimit mbi vlerën e shtuar në blerje dhe tatimit mbi vlerën e shtuar në shitje. Një shumë e konsiderueshme inventari e blerë gjatë muajit dhjetor është gjendje në fund të periudhës dhe ka shkaktuar këtë diferencë

6. Inventarët

Shoqëria përdor disa lloje të inventarëve të nevojshëm për aktivitetin e vet në formën e materialeve kryesore dhe materiale të tjera ndihmëse. Ajo përdor metodën e inventarizimit të vazhduar për evidentimin në kontabiltet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventaret janë vlerësuar me kosto e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si me e vogla e krahasuar me vlerën neto të realizueshme. Inventarët paraqiten si vijon:

Inventari	Viti 2012 Në lekë	Viti 2011 Në lekë
Lëndët e para	5,218,380	0
Inventar i imët	177,122	104,600
Totali 4	5,395,503	104,600

Gjendja e materialeve kryesore përbëhet si më poshtë vijon:

Materiale te para e te tjera	Viti 2012 Lekë
Hekur ndertimi	4,782,058
Profile metalike	10,480
Aditiv betoni	82,807
Tel Bari	169,700
Materiale Elektrike dhe tjera	173,335
Totali	5,218,380

7. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Në këtë zë paraqiten të gjitha shumat e paguara që i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë në të ardhmen si dhe të gjitha pagesat për lejet e ndërtimit, për projektet e ndërtimit dhe për studime për të gjitha objektet e ndërtimit në process dhe të papërfunduara në fund të periudhës. Shuma 15,800,000 lekë gjendje në fund të vitit 2011 përfaqëson shumat e shpenzuara nga shoqëria për lejet e ndërtimit të objekteve që në fakt kishin përfunduar në fund të këtij viti. Prandaj ato kanë kaluar në shpenzime gjatë viti 2012.

Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet ne tabelen me poshte:

NORD KONSTRUKSION SH.P.K.
SHËNIMET SHPJEGUESE

Parapagime, shpenzime te shtyra	Viti 2012 Në lekë	Viti 2011 Në lekë
Parapagime për leje ndërtimi (objektet e perfunduara)	0	15,800,000
Totali	0	15,800,000

8. Aktivët Afatgjatë

Gjendja dhe shtesat e pakësimit e Aktivëve Afatgjatë Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2012 paraqiten si në tabelën vijuese:

Emertimi i aktivit	Gjendja më 01.01.2012	Shtesat		Blere dhe krijuar	Pakësime		Gjendja më 31.12.2012
		Ardhur nga parapagimet	Ardhur nga parapagimet		Nxjerja i/përdorimit	Transferime	
Toka	-						
Ndertesa	410,000						410,000
Pajisje Gabina Elektrike	796,306						796,306
Makinieri e pajisje	446,450						446,450
Mjete transporti	1,389,100						1,389,100
Pajisje informatike,	584,537			53,708			638,245
Pajisje zyre	310,161						310,161
Parapagime për AAM							
Totali i AAM me vlerën bruto	3,936,554			53,708			3,990,262
Amortizimi i AAM							
Emertimi i aktivit	Gjendja 01.01.2012	Nga Riklasifikime	Amortizimi vjetor	Nga nxjerja i/përdorimit	Riklasifikime		Gjendja 31.12.2012
Toka	-						-
Ndertesa	20,500		19,475				39,975
Pajisje Gabina elektrike	159,261		127,409				286,670
Makinieri , pajisje dhe vegla	89,290		71,432				160,722
Mjete Transporti	444,507		188,919				633,426
Pajisje informatike	270,452		88,951				359,403
Pajisje Zyre	28,143		56,403				84,546
Totali	1,012,153		552,589				1,564,742
AAM Neto	2,924,401		552,589				2,425,520

8. Aktivët Afatgjatë (Vazhdim)

Në bilanc Aktivët Afatgjatë paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar. Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura janë në përputhje me kërkesat e Ligjit 8438 datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të ardhurat". Këto norma marrin parasysh përafërsisht edhe jetëgjatësinë e përdorimit të këtyre aktiveve nga shoqëria. Shoqëria nuk ka ndryshuar politikat kontabile në lidhje me Aktivët afatgjatë në raport me vitin e kaluar.

9. Detyrimet

Detyrimet e shoqërisë përbëhen nga detyrimet afatgjatë dhe afatshkurta. Në bilanc ato paraqiten si vijon:

DETYRIME	Viti 2012 Në Lekë	Viti 2011 Në Lekë
Detyrime afatgjatë nga qeraja Financiare (leasing)	-	71,325
Detyrime afatshkurta		
Totali	-	71,325

9.1 Detyrimet afatshkurta

Paraqitja e tyre në bilancin kontabel jepet si në tabelën që vijon:

Huat dhe parapagimet	Viti 2012 Në Lekë	Viti 2011 Në Lekë
Te pagushme ndaj furnitorëve	169,279,877	224,797,455
Te pagushme ndaj punonjësve	482,313	900,257
Detyrime për sigurimet shoqërore e Shendetesore	106,068	97,762
Detyrime për tatimin mbi pagat (T.A.P)	47,901	46,301
Hua dhe detyrime të tjera		
Parapagimet e arketuara	11,555,160	
Totali	181,471,319	225,841,775

9.1.1 Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2012. Gjithashtu detyrimet në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit dhe diferencat kanë kaluar në rezultat. Përbërja e këtyre detyrimeve paraqiten si vijon:

NORD KONSTRUKSION SH.P.K.
SHËNIMET SHPJEGUESE

<i>Të pagueshme ndaj furnitorëve</i>	Viti 2012	Viti 2011
	Në Lekë	Në Lekë
Alba Beton sh.p.k	9,564,815	83,717,070
Ani sh.p.k Lac	7,002,279	3,491,567
Rafaelo 2002 sh.a	20,405,199	0
Beka K-07 Sh.p.k	126,702	0
Babeta Trasport sh.p.k	1,336,263	0
Gjakova G sh.p.k	5,449,573	5,449,573
Hasanaj Konstruksion sh.p.k	2,187,767	
A - Jozy sh.p.k	35,217,233	42,778,313
Santara sh.p.k	86,517,332	86,517,332
Te tjere funitore	1,563,627	2,843,600
Totali	169,279,877	224,797,455

9.1.2 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe të tjera të pagueshme në lidhje me pagat

Në këto zëra përfshihen detyrimet për pagat e papaguara të muajit dhjetor si dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale dhe që janë paguar gjatë muajit Janar 2013.

10. Kapitale të veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Kapitali	Viti 2012	Viti 2011
	Në lekë	Në lekë
Kapitali aksionar	267,745,000	151,660,000
Rezerva ligjore	1,662,351	1,662,323
Rezerva të tjera		
Fitimet e pashpërndara		
Fitimi (humbja) e vitit financiar	(26,606,312)	116,085,028
Totali i kapitalit	242,801,039	269,407,351

Gjatë vitit 2012 Asambleja e shoqërise vendosi që fitimin e vitit 2011 prej 116,085,000 lekë ta kapitalizojë.

11. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave dhe Shpenzimeve sipas funksionit.

11.1 Shitjet neto

Shoqëria realizon të ardhurat kryesore të aktivitetit të saj nga punimet e ndërtimit të cilat paraqiten në të ardhura sipas faktit të punimeve të kryera (situacioneve mujore dhe progresive) në përputhje me SKK 8. Në tabelën vijuese jepet një paraqitje e shitjeve neto:

Shitjet neto	Viti 2012 Në Lekë	Viti 2011 Në Lekë
Të ardhurat nga punimet (situacionet)	71,978,360	210,149,524
Totali i shitjeve neto	71,978,360	210,149,524

11.2 Kosto e punimeve

Në koston e punimeve përfshihen të gjitha shpenzimet direkte që kryhen për aktivitetin kryesor të shoqërisë dhe përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

Elementët	Viti 2012 Në Lekë	Viti 2011 Në Lekë
Materiale të para dhe ndihmëse	48,527,648	12,617,740
Kosto e fuqisë puntore	2,679,416	4,910,733
Punime të kryera nga të tretë	16,700,914	28,809,233
Taksa e lejes	0	20,455,000
Të tjera	55,000	50,478
		0
Totali	67,962.978	66,843,184

11.3 Shpenzimet administrative

Në shpenzimet administrative përfshihen shpenzime që janë kryer për administratën dhe nuk kanë lidhje me aktivitetin kryesor të shoqërisë

Elementët	Viti 2012 Në Lekë	Viti 2011 Në Lekë
Energji elektrike	1,600	0
Qira		240,000
Sigurime		32,965
Sherbim i rojeve	300,000	150,000
Shpenzime postare dhe telekomunikacion	1,095,309	1,339,073
Personel jashte ndermarrjes	0	290,000
Totali	1,396,909	2,052,038

11.4 Shpenzimet e shitjes

Në shpenzimet e shitjes përfshihen shpenzimet që bëhen nga departamenti i shitjes dhe përfshijnë kostot e personelit të shitjes dhe shpenzimet për taksat e kalimit të pronësisë

NORD KONSTRUKSION SH.P.K.
SHËNIMET SHPJEGUESE

Elementët	Viti 2012 Në Lekë	Viti 2011 Në Lekë
Kosto e personelit	4,142,206	3,842,428
Taksa e kalimit të pronësisë (per objektet e perfunduara)	8,064,210	6,777,329
Totali	12,206,416	10,619,757

11.5 Shpenzime të tjera operative

Në shpenzime të tjera operative përfshihen shpenzimet e amortizimit, shpenzime riparim mirembajtje, komisione për shërbime bankare, taksa dhe tarifa vendore dhe në vitin 2012 përfshihen shpenzimet e vitit 2011 për taksat e lejeve të ndërtimit të cilat duhet të kishin kaluar në shpenzime të vitit 2011

Elementët	Viti 2012 Në Lekë	Viti 2011 Në Lekë
Shpenzime amortizimi	552,589	620,482
Shpenzime riparim mirëmbajtje	33,300	18,300
Shërbime bankare	80,070	78,277
Taksa dhe tarifa vendore (te objekteve te perfunduara)	15,859,515	0
Të tjera	404,305	623,993
Totali	16,929,779	1,341,052

11.6 Shpenzime personeli

Shpenzimet për personelin janë të shpërndara sipas funksioneve, por në total ato përfshijnë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2012. Gjatë vitit shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit. Ato detajohen si më poshtë:

Pagat e personelit -	Viti 2012 Në Lekë	Viti 2011 Në Lekë
Pagat	6,120,900	7,890,218
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	700,724	862,943
Shpërblime dhe honorare	0	0
Totali	6,821,624	8,753,161

11.7 Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

NORD KONSTRUKSION SH.P.K.
SHËNIMET SHPJEGUESE

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në valutë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve dhe e te drejtave dhe detyrimeve të shprehura në monedha të huaja. Paraqitja e tyre jepet në tabelën vijuese:

Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	Viti 2012 Në Lekë	Viti 2011 Në Lekë
<i>Humbje nga këmbimi</i>	92,513	34,949
Fitime nga këmbimi		
Rezultat neto i veprimeve nga këmbimi	(92,513)	(34,949)

13. Fitimi neto

Shoqëria ka rezultuar me një humbje neto kontabël **26,606,312** leke. Shoqëria ka ruajtur një nivel fitimi 6% në aktivitetin e ndërtimit, por shpenzimet e tjera kanë qenë të konsiderueshme sidomos shpenzimet për taksën e kalimit të pronësisë dhe taksa 5% e lejes së objekteve të përfunduara dhe hipotekura që ka ndikuar padrejtësisht rezultatin e periudhës aktuale

14. Transaksionet me palë të lidhura

Sipas statutit të shoqërisë, organi më i lartë vendimmarrës është asamblea e ortakëve. Shoqëria drejtohet nga administratori i saj. Nuk ka transaksione me palë të lidhura, përveç një huaje me vlerë 1,891,078 lekë që i është dhënë një personi të njohur të administratorit.

15. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.